



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KURBIN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 200/prot.

Laç më 30/01/2024

VENDIM

Nr. 03 datë 25/01/2024

**“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET APLIKUESE, TË CILAT NUK JANË SHPALLUR PËRFITUESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT DHE QË DO TË TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%) PËR NDIHMËN EKONOMIKE”.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të nenit 29 të ligjit 57/2019, datë 18.07.2019, “Për Asistencen Sociale ne Republikën e Shqiperise ”neni 31 pika 2, të VKM së Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, te dokumentacionit dhe te mases mujore te perfitimit te Ndihmes Ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per Ndihmë Ekonomike” dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, dhe pas propozimit nga Kryetarja e Bashkise, KESHILLI BASHKIAK:

VENDOSI;

- 1.Miratimin e kritereve perkatese për përzgjedhjen e familjeve në nevojë që do të trajtohen në fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar 6% për ndihmën ekonomike, sipas pikave te caktuara.

**KRITERET PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET QE DO TË TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR 6%.**

1. Kryefamiljare të veja me një e më shumë fëmijë me gjendje të vështirë social-ekonomike.
2. Persona të vetmuar dhe endacakë me moshë madhore mbi 50 vjec pa të ardhura ekonomike.
3. Persona apo familje të ngujuar të vërtetuar me dokumentacion ligjor të Kryeplakut, Komisariati, Punonjësi i rendit të Zonës, Prokuroria.
4. Familje me gjendje të vështirë social-ekonomike që rezultojnë me një person madhor të humbur, të vërtetuar me një dokumentacion nga organet e rendit apo drejtësisë.
5. Familje të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në kushte të vështira sociale dhe ekonomike.
6. Vajzat nëna me familje 0-18 vjec, pa mbeshtetje dhe që jetojnë në kushte të vështira social-ekonomike.
7. Viktimat e dhunes (familje) që u ka mbaruar afati i perfitimit percaktuar sipas ligjit 57/2019.
8. Familje të divorcuara dhe me gjendje të vështirë ekonomike.
9. Familje në nevojë (jo perfituese në sistem) të verifikuara me komisionin që rezultojnë në kushte të rënduara ekonomike-sociale.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ( dhjete) dite pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

>Prefektit Të Qarkut Lezhë

>Drejtoria E Ndhimes Ekonomike Dhe Kujdesit Social

>Arkivi

**Sekretari i Këshillit**

**Arber Leka**



**Kryetare e Keshillit**

**Edlira Lleshi**

